

KËRKESË PËR RISHQYRTIM

Sipas Nenit 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: **KOMUNA E ISTOGUT**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr i Prokurimit	633-25-7013-2-2-1
Nr i brendshëm	

Sa i përket tenderit për

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	IPE-PROING SH.P.K
NUI	810841644
Adresa	Dardania Bl 1/1 Hy.1
Vendi	Prishtinë
Kodi postar	10000
Numri Telefonit	044131508
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	Nebi Pllana
Adresa elektronike	proing@msn.com
Data e parashtrimit të kërkesës	08.08.2025

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtrojë kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-i
Adresa elektronike t

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

MBIKQYRJA E PROJEKTEVE PER INFRASTRUKTURE.(633-025-047-221)

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐

Jo ☐

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Kërkesë për Rishqyrtim të Kërkesave Teknike – Pika 3 dhe Pika 4

Procedura: MBIKQYRJA E PROJEKTEVE PËR INFRASTRUKTURË (633-025-047-221)

Nr. i prokurimit: 633-25-7013-2-2-1

I nderuar Autoritet Kontraktor,

Në cilësinë e operatorit ekonomik të interesuar për pjesëmarrje në procedurën Mbikëqyrja e Projekteve për Infrastrukturë, dhe duke u bazuar në parimet e konkurrencës së hapur, proporcionalitetit dhe mosdiskriminimit të përcaktuara në Ligjin për Prokurimin Publik, paraqesim këtë kërkesë për rishqyrtim të disa kriterëve teknike të specifikuara në dokumentacionin e tenderit, konkretisht në Pikën 3 dhe Pikën 4.

KËRKESAT EKZISTUESE NË DOKUMENTACION

Pika 3 – Certifikatat ISO

Operatori Ekonomik duhet të jetë i pajisur me certifikatat valide:

- ISO 9001:2015 Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë
- ISO 14001:2015 Sistemi i Menaxhimit të Mjedisit
- ISO 45001:2018 Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë
- ISO 10002:2018 Menaxhimi i Cilësisë

Dëshmia: Kopje valide të certifikatave.

Pika 4 – Mjetet, stabilimentet dhe pajisjet teknike

Operatori Ekonomik duhet të posedojë mjetet, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projekteve (matje precize dhe profesionale gjeodezike):

4.1 Pajisje gjeodezike sistem LIDAR 3D SKANER MULTI FUNKSIONAL me 4 opsione: Handy Station Mobile, Vehicle Station, GNSS RTK Station dhe UAV Drone Station, për mundësi kombinimi simultan të lokalizimit dhe mapimit SLAM, për përdorim me dron dhe montim mbi veturë, me HDR kamerë panoramike dhe mobile software, me këto specifika: saktësi 0.5 cm deri 2 cm, minimumi 320.000 pika/sekondë, memorie 1 TB.

4.2 Pajisje gjeodezike GPS GNSS RTK – ADVANCED engine system me 1.408 kanale satelitore, me dual kamerë në kokë resiver dhe kontrollor Handy me dual kamerë në kontrollor-terminal, me opsion rievimi – skanim 3D me fotografi dhe piketim real view me kamerë dhe software 3D.

4.3 Pajisje gjeodezike sistem LIDAR 3D për dron me këto specifika minimale: kamerë të integruar 26 MP, sensor leximi 1.920.000 pika/sekondë, saktësi pozicionimi 1 cm horizontal dhe 2 cm vertikal, fushë veprimi deri në 300 m, memorie 1 TB.

4.4 Së paku 4 automjete (vetura) në pronësi të kompanisë për kryerjen e shërbimeve të mbikëqyrjes.

ARSYETIMI PËR RISHQYRTIM

1. Për Pikën 3 (Certifikatat ISO):

- Kërkesa për të gjitha këto certifikata ISO njëkohësisht mund të jetë kufizuese për operatorët që posedojnë certifikatat më të lidhura drejtpërdrejt me natyrën e projektit (p.sh. ISO 9001 dhe ISO 14001), por jo domosdoshmërisht të gjitha.
- Standardet ISO 45001 dhe ISO 10002, megjithëse të dobishme, nuk janë gjithmonë të domosdoshme për punë të natyrës së mbikëqyrjes gjeodezike dhe inxhinierike.

2. Për Pikën 4 (Pajisjet):

- Pajisjet e listuara janë shumë specifike dhe posedohen nga një numër i kufizuar operatorësh në tregun vendor dhe rajonal.
- Parametrat teknikë (p.sh. numri fiks i kanaleve GNSS, kapacitet memorie 1 TB fiks, numri i pikave për sekondë, saktësia në cm pa tolerancë) kufizojnë mundësinë e përdorimit të pajisjeve alternative.
- Kërkesa për 4 modalitete pune në një pajisje LIDAR 3D është më e lartë se nevoja minimale profesionale për projektin.
- Kërkesa që automjetet të jenë vetëm në pronësi përjashton mundësinë e përdorimit me qira.
- Punët e këtij projekti mund të realizohen plotësisht edhe me pajisje të tjera që nuk përputhen 100% me parametrat e specifikuar, por që sigurojnë të njëjtën saktësi, cilësi dhe efikasitet.

PROPOZIMI PËR MODIFIKIME/LEHTËSIME

1. Për Pikën 3:

- Të kërkohej si detyrim vetëm certifikatat ISO më të lidhura me projektin (p.sh. ISO 9001 dhe ISO 14001), ndërsa ISO 45001 dhe ISO 10002 të jenë kritere shtesë jo-detyruese.

2. Për Pikën 4:

- Të lejohet ofrimi i pajisjeve alternative që përmbushin qëllimin e projektit, edhe nëse nuk kanë të gjitha parametrat e listuar fiks.
- Për parametrat teknikë të përcaktohet interval i pranueshëm (p.sh. saktësi deri ± 1 cm, memorie = 512 GB, PPS $\pm 20\%$ nga vlera e kërkuar).
- Për LIDAR 3D të lejohet minimumi 2 modalitete pune në vend të 4 të detyrueshme.

Përfundim:

Këto ndryshime do të:

- Rrisin pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë;
- Sigurojnë konkurrencë të drejtë;
- Lejojnë përdorimin e pajisjeve të ndryshme por të barasvlershme në cilësi;
- Respektojnë standardet profesionale dhe ligjore në realizimin e projektit.

Me Respekt: IPE-PROING SH.P.K.

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*

- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.*